



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.181/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.03.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së BOE “D&E” shpk& “Kristal 2001” shpk, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-95458-11-22-2018 me objekt “Blerje uniforma dhe paisje sigurie per punonjesit e OSHEE”, me fond limit 198,150,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 17.12.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

Ankimues: BOE “Marsi” &AL” & “MSCC” & “Koan” shpk
Qendra Blur, kati I, Lundër, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: OSHEE sh.a
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Tiranë

Subjekt i Interesuar: D&E” shpk& “Kristal 2001” shpk
Njesia Bashkiake Nr.5, Rruga Milto Tutulani, Pallati Alb
Millenium Nr.6, Kati II, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të

Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 22.11.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-95458-11-22-2018 me objekt “Blerje uniforma dhe paisje sigurie per punonjesit e OSHEE”, me fond limit 198,150,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 17.12.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

II.2. Në datën 17.12.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 28.01.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Muca	pa ofertë	I skualifikuar
- D&E	158,010,000	I kualifikuar
- Malbertex	168,156,000	I skualifikuar
- Marsi&Al	190,530,000	I kualifikuar

II.5. Në datën 01.02.2019 BOE ankimues “Marsi” &AL” & “MSCC” & “Koan” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e BOE D&E shpk& “Kristal 2001” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Në shtojcën 9 në kriteret teknike përkatësisht pika 2.3.1 citojmë: **2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, ku vlera duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 60,000,000 (gjashtedhjetë milion) leke. Në rast se kontrata është kryer me ente publike - Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rast se kontrata është kryer me sektorin privat: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Për të përmbushur këtë kriter shoqëria Kristal 2001 shpk pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë D&E shpk&kristal 2001 shpk ka paraqitur fatura doganore të cilat nuk shprehin qartë punën e kryer dhe gamën e artikujve për tu konsideruar si përvojë e ngjashme. Faturat duhet të jenë tatimore sikurse shprehet edhe në kriter dhe konsiderimi i rregullt i faturave doganore përbën një shkelje të procedurës. I kërkojmë AK të bëjë verifikimet e duhura në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri.

- Në shtojcën 9 në pikën d) kriteret e vecanta të kualifikimit kërkohet: Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Për këtë në dijeninë tonë shoqëria kristal 2001 shpk ka paraqitur vërtetim nga OSHEE shpërndarë muajin nëntor 2018. Mosplotësimi i këtij kriteri konstatohet në skualifikim të ofertës dhe jo në kualifikim të saj.

- Në shtojcën 9 kapacitetet teknike në pikën 2.3.2 citojmë: 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te jete i pajisur, me certifikate per sistemin e menaxhimit te cilesise ISO 9001 dhe me certifikate per Sistemin e Menaxhimit Mjedisor ISO14001, te leshuara nga nje organ i akredituar.

Në lidhje me këtë shoqëria kristal 2001 shpk nuk e plotëson këtë kriter sepse ISO 9001 dhe ISO 14001 të paraqitura nga ana e saj nuk janë të akredituara nga një organ i akredituar sikurse theksohet në këtë kriter. I kërkojmë AK të bëjë verifikimet përkatëse në lidhje me plotësimin e këtij kriteri kualifikimi.

- Në shtojcën 9 kriteret teknike në pikën 2.3.6.5 kërkohet: *Certifikate e nje laborator te akredituar qe tregon konformitetin e kepuces mbrojtese sipas normatives EN ISO 20345:2011 S3 SRC.*

Shoqëria Kristal shpk nuk ka paraqitur një certifikatë nga laborator të akredituar për të vërtetuar konformitetin e këpucës mbrojtëse sipas normativave EN ISO 20345:2011 S3 SRC. Për sa më sipër mungesa e një certifikate të tillë përbën edhe mosplotësim të kriterit të kualifikimit dhe për këtë i kërkojmë AK të bëjë verifikimet e duhura në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria Kristal 2001 shpk.

Sa më sipër shoqëria Kristal 2001 shpk pjesë e BOE D&E shpk & Kristal 2001 shpk nuk ka plotësuar pikat e mësipërme. Për rrjedhojë i kërkohet AK të bëjë edhe skualifikimin e ofertës ekonomike të paraqitur nga ky BOE dhe të bëjë rivlerësim të ofertave për objektin e prokurimit.

II.6. Në datën 08.02.2019 me shkresën nr. 2679/2 prot BOE ankimues është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 18.02.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.4555/1 prot datë 26.02.2019 protokolluar me tonën me nr.251/2 datë 28.02.2019 me objekt “*Dërgohet informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Marsi” &AL” & “MSCC” & “Koan” shpk” për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “D&E” shpk& “Kristal 2001” shpk me argumentin se “Në shtojcën 9 kriteret teknike në pikën 2.3.6.5 kërkohet: *Certifikate e nje laborator te akredituar qe tregon konformitetin e kepuces mbrojtese sipas normative EN ISO 20345:2011 S3 SRC. Shoqëria Kristal shpk nuk ka paraqitur një certifikatë nga laborator të akredituar për të vërtetuar konformitetin e këpucës mbrojtëse sipas normativave EN ISO 20345:2011 S3 SRC. Për sa më sipër mungesa e një certifikate të tillë përbën edhe mosplotësim të kriterit të kualifikimit dhe për këtë i kërkohet AK të bëjë verifikimet e duhura në dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria Kristal 2001 shpk.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Certifikate e nje laborator te akredituar qe tregon konformitetin e kepuces mbrojtese sipas normative EN ISO 20345:2011 S3 SRC.*

III.1.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër sqarohet se: *Në lidhje me dorëzimin e certifikatës të lëshuar nga laborator të akredituar për të vërtetuar konformitetin e këpucës mbrojtëse sipas normativave EN ISO 20345 bazuar në nenin 45 shqyrtimi I ofertave , autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat , kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në DT, si dhe gabime shtypi të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.*

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se BOE D&E” shpk& “Kristal 2001” shpk nuk ka dorëzuar një certifikatë të lëshuar nga një laborator i akredituar që tregon konformitetin e kepuces mbrojtese sipas normative EN ISO 20345:2011 S3 SRC për të përmbushur kriterin e sipërcituar.

III.1.4. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kërkesat kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin “*Certifikate e nje laborator te akredituar qe tregon konformitetin e kepuces mbrojtëse sipas normativës EN ISO 20345:2011 S3 SRC*”. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga BOE “D&E” shpk& “Kristal 2001” shpk rezulton se ky i fundit nuk dorëzuar një dokument të tillë. Gjithashtu referuar kthim përgjigjes drejtuar ankimuesit lidhur me pretendimin sa më sipër autoriteti kontraktor ka pranuar se një dokument i tillë mungon duke e konsideruar këtë një devijim të vogël. KPP gjykon se jemi në kushtet e mungesës fizike të një dokumenti i cili është pjesë e kërkesave dhe kriterëve kualifikuese për të gjitha ofertuesit në këtë procedurë ndaj autoriteti nuk mund ta konsiderojë mospërmbushjen e një kriteri devijim të vogël.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se BOE D&E & Kristal 2001 shpk nuk plotësojnë kriterin e vecantë të kualifikimit, pasi nuk kanë paraqitur dokument në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

III.1.6. Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *“Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik”;*

“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”; Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues duhetë kishte paraqitur të gjithë dokumentacionin në përputhje me kriteret dhe kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.7. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë ankimues do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër pretendimet e BOE ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues mbi skualifikimin e BOE D&E&Kristal 2001 shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit mësipër, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë D&E&Kristal 2001 shpk do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi duke përmbushur interesat e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Marsi” &AL” & “MSCC” & “Koan” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-95458-11-22-2018 me objekt “*Blerje uniforma dhe paisje sigurie per punonjesit e OSHEE*”, me fond limit 198,150,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 17.12.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e BOE “D&E” shpk & “Kristal 2001” shpk, shpk duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Marsi” &AL” & “MSCC” & “Koan” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 251 Protokolli; Datë 18.02.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha